



Prishtinë, 28 qershor 2013

Kodi i ZRRE-së: V_545_2013

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenit 14, paragrafët 2.16, 2.17 , dhe Nenit 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 31 të Ligjit për Ngrohjen Qendrore (Ligji Nr 03/L-116);
- Dispozitat e Nenit 4 të Licencës për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së Ngrohjes ; dhe
- Kërkesën për miratimin e dokumentit “Kodi i shpërndarjes”, dorëzuar nga Ngrohtorja e Qytetit “Termokos” SH.A., adresa: rruga “28 Nëntori”, p.n. - Dardani/Prishtinë, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 28 qershor 2013 nxori këtë:

VENDIM

I. APROVOHET “Kodi i Shpërndarjes” i Ngrohtores së Qytetit Termokos SH.A.

Arsyetim

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar kërkesën e të licencuarit - NQ Termokos SH.A. për miratim të dokumentit: “ Kodi i shpërndarjes”.
 2. Pas shqyrtimit të draft-dokumentit “Kodi i shpërndarjes” të dorëzuar nga NQ Termokos dhe përmirësimit e plotësimit të tij sipas komenteve të ZRRE-së, Bordi i ZRRE -së duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II.** I licencuari obligohet që pas pranimit të këtij vendimi menjëherë të publikojë dokumentin “Kodi i shpërndarjes” në faqen elektronike zyrtare të tij.
- III.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bashkëngjitur këtij vendimi është: "Kodi i shpërndarjes" i NQ Termokos.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, Kryesues

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar

Merita Kostari, Anëtare

Krenar Bujupi, Anëtar